



Funded by
the European Union



“Korrupsioni në Doktoraturat e Universitetit të Tiranës – Analiza e Problemit dhe Rekomandime për Zgjidhje.”

Subian Dalani

Student, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Shtator 2024

Ky artikull u realizua në kuadër të projektit “Studentët e Drejtësisë në Frontin kundër Korrupsionit!”, që është pjesë e mekanizmit të skemave të nëngranteve të projektit ‘Mbështesim Pjesëmarrjen, Përgjeshmërinë dhe Fuqizimin e Shoqërisë Civile’(SPACE), financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga shoqata Together for Life, në bashkëpunim me BIRN Albania, Qëndresa Qytetare dhe DCE”. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e autorit dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian, apo organizatave zbatuese.



Doktoratura është një nivel i avancuar i studimeve akademike që përfshin hulumtime të thelluara në një fushë specifike të dijes dhe përfundon me paraqitjen e një disertacioni origjinal. Në Shqipëri, doktoraturën mund ta shkruajnë individë që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare (Master) dhe që pranohen nga një institucion i akredituar për ofrimin e këtij niveli studimesh. Aplikantët duhet të përmbushin kriteret e vendosura nga universiteti dhe të angazhohen në kërkim shkencor të pavarur nën mbikëqyrjen e një mentori akademik. Doktoraturat përfaqësojnë kulmin e arsimit akademik dhe janë thelbësore për avancimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e brezit të ardhshëm të akademikëve. Aktualisht për vitin akademik 2023-2024, Universiteti i Tiranës ofron 38 programe doktorature, të organizuara në disa fakultete të ndryshme, si Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dhe Fakulteti i Shkencave Sociale. Disa nga programet përfshijnë doktoraturë në fusha si: Shkenca Juridike, Ekonomike, Letërsi, Gjeografi, Bioteknologji, dhe Informatikë. Universiteti synon të ofrojë një gamë të gjerë specializimesh për studentët që duan të ndjekin karrierën akademike dhe shkencore. Ky raport synon të analizojë natyrën dhe shtrirjen e korrupsionit në doktoratura, si dhe të ofrojë rekomandime për ta adresuar këtë problem të ndjeshëm.

Korrupsioni është një fenomen shqetësues për shoqërinë shqiptare. Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit 2023 të Transparency International, korrupsioni vazhdon të jetë një çështje shqetësuese për vendin tonë. Shqipëria renditet në vendin e 98-të nga 180 vende. Sipas Nye, korrupsioni është “një sjellje që devijon nga detyrimi normal i rolit publik për shkak të përqëndrimeve private, përfitimit të parave apo statusit, apo thyerje e rregullave kundër përdorimit të llojeve të përqëndrimeve private. Kjo përfshin sjellje si rryshfeti, nepotizmi dhe shfrytëzim.” Korrupsioni në doktoratura manifestohet në forma të ndryshme, duke përfshirë favorizimin e kandidatëve për doktoraturë, shpërdorimin e fondeve kërkimore dhe emërimet e padrejta në komisionet e vlerësimit. Korrupsioni në arsimin e lartë është i një fenomen i ndërlikuar dhe i ndërlidhur me faktorë të tillë si nepotizmi, klientelizmi dhe mungesa e transparencës në proceset e pranimit dhe mbrojtjes së temave doktrale. Shpesh, kandidatët e doktoratës përballen me presion për të paguar rryshfete ose për të krijuar marrëdhënie me profesorët për të siguruar miratimin e temave të tyre apo për të marrë mbështetje në komisionet e vlerësimit. Një tjetër problem i theksuar është mungesa e transparencës në ndarjen e fondeve për kërkimet shkencore. Shpesh, këto fonde u akordohen individëve që kanë lidhje të ngushta me anëtarët e fakultetit, duke lënë jashtë shumë kandidatë të denjë. Kjo jo vetëm që dëmton cilësinë e kërkimeve të prodhuara dhe minon besueshmërinë e doktoraturave, por mund të zvogëlojë prestigjin e arsimit të lartë kombëtar, të ulë aftësinë për të negociuar për diploma të përbashkëta, si dhe të limitojë aftësinë për të përthithur punonjës të rinj. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se 5 vite akademike.

Gjetjet Kryesore & Rekomandimet:

Korrupsioni ka ndikuar ndjeshëm në procesin e doktoraturave duke shkaktuar probleme serioze në integritetin akademik dhe cilësinë e hulumtimeve. Një nga problematikat kryesore është blerja dhe plagjiatura e disertacioneve, ku disa studentë arrijnë të përfitojnë diploma pa



përbushur standardet akademike. Kjo praktikë ndikon negativisht në reputacionin e universitetit dhe të sistemit arsimor në tërësi.

Një tjetër problem është ndërhyrja e faktorëve të jashtëm, si favorizimi apo lidhjet politike, që ndikojnë në përzgjedhjen dhe avancimin e kandidatëve për doktoratë. Këto praktika kanë çuar në uljen e cilësisë së kërkimeve shkencore, duke favorizuar individët që nuk përmbushin standardet akademike të kërkuara.

Mungesa e mbikëqyrjes efektive nga ana e institucioneve përgjegjëse dhe mosrespektimi i rregullave të etikës akademike janë faktorë shtesë që e përkeqësojnë situatën, duke penguar zhvillimin e një kulture të kërkimit të bazuar në meritokraci dhe rigorozitet.

Nga analizimi i situatës aktuale, dolën në pah disa gjetje kryesore:

- Korrupsioni në programet e doktoraturës është përhapur kryesisht për shkak të mungesës së rregullave të qarta dhe të zbatuara mirë në lidhje me procesin e pranimit dhe mbrojtjes së temave doktorale.
- Mungesa e fondeve të drejta dhe të shpërndara në mënyrë transparente krijon një hendek të madh mes kandidatëve për doktoraturë, duke favorizuar vetëm një grup të ngushtë.
- Emërimi i komisioneve të vlerësimit shpesh bëhet bazuar në lidhje personale, dhe jo në kritere profesionale dhe akademike.

Për të luftuar korrupsionin në doktoratura duhet të zbatohen një sërë masash të rekomanduara, duke përfshirë transparencën, mbikëqyrjen dhe rritjen e standardeve akademike. Disa nga masat kryesore që duhet të merren janë:

1. **Forcimi i sistemit të antiplagjiaturës:** Universiteti duhet të përdorë teknologji të avancuara për të kontrolluar disertacionet për plagjiaturë në mënyrë rigoroze. Sistemet e automatizuara të kontrollit të punimeve shkencore duhet të jenë një kusht i detyrueshëm për miratimin e doktoraturave.
2. **Transparenca në procesin e pranimit dhe mbrojtjes së doktoraturës:** Proceset e përzgjedhjes së kandidatëve dhe mbrojtjes së disertacioneve duhet të jenë të hapura dhe transparente. Kjo përfshin publikimin e disertacioneve të doktoraturës dhe procedurave të mbrojtjes për të mundësuar një vlerësim publik të punimeve
3. **Rritja e rolit të mentorëve dhe vlerësuesve të jashtëm:** Mentorët akademikë dhe vlerësuesit e pavarur nga jashtë duhet të përfshihen në mënyrë më të theksuar për të garantuar cilësinë dhe paanshmërinë e kërkimit shkencor. Këta mentorë duhet të jenë përgjegjës për ndjekjen e procesit të punës kërkimore dhe integritetin e tij.
4. **Zbatimi i rregullave të etikës akademike:** Duhet të vendosen masa të forta disiplinore për shkeljet e etikës, përfshirë masa kundër plagjiaturës, manipulimit të të dhënave dhe favorizimit. Universiteti duhet të forcojë zbatimin e rregullave që lidhen me transparencën dhe cilësinë e kërkimeve.
5. **Mbikëqyrja e jashtme nga organet e akreditimit dhe qeverisjes:** Organet e pavarura të akreditimit dhe institucionet e qeverisjes së arsimit të lartë duhet të kryejnë auditime të rregullta të programeve të doktoraturës për të siguruar që po ndiqen standardet e kërkuara akademike



6. **Krijimi i një mekanizmi të pavarur denoncimi:** Krijimi i këtij mekanizmi do të lejojë kandidatët të raportojnë raste korrupsioni pa frikën e pasojave të mundshme, duke rritur transparencën dhe sigurinë e tyre. Ky mekanizëm duhet të jetë anonim dhe i mbrojtur ligjërisht, duke garantuar që denoncuesit të mos përballen me penalizime akademike apo presion nga profesorët. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një kulture të re të përgjegjshmërisë dhe integritetit në universitet.
7. **Emërimi i komisioneve të vlerësimit në bazë të meritës profesionale:** Është një hap thelbësor për të eliminuar nepotizmin dhe klientelizmin. Këto komisione duhet të përbëhen nga akademikë me reputacion të lartë dhe pa lidhje personale me kandidatët, duke siguruar që vendimet e tyre të jenë objektive. Zbatimi i këtij parimi do të çojë në një sistem vlerësimi të drejtë dhe profesional, ku përparësia i jepet cilësisë dhe kërkimeve shkencore.

Përfundimi: Korrupsioni në dhënie e doktoraturave është një problem që minon integritetin e institucionit dhe cilësinë e kërkimit shkencor. Për të rikthyer besimin në këto programe dhe për të siguruar që doktoraturat e lëshuara të kenë vlerë të lartë akademike, është thelbësore që të ndërmerren masa të fuqishme për të luftuar korrupsionin. Zbatimi i masave do të ndihmojë në ndalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së kërkimeve shkencore. Vetëm në këtë mënyrë, të rritet cilësia e arsimit dhe të përgatiten studiues të aftë dhe të integruar në shkencën ndërkombëtare. Korrupsioni nuk e shfaq efektin e tij në periudhë afatshkurtër, por në periudhë afatgjatë.



Funded by
the European Union



Bibliografia:

- Transparency International. (2023). Korrupsioni në Arsimin e Lartë: Një analizë e vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- OECD. (2022). Raporti mbi Integritetin në Arsimin e Lartë.
- European University Association. (2023). Fighting Corruption in Doctoral Programs.
- Statuti, Rregullorja dhe Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës.